

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TËLO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr/Br. 983/20
Datë/Datum. 20.11.20

PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Për Aktivitetin e Prokurimit: **214-20-5150-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **“Furnizimi dhe montimi i pajisjeve në laboratorët e AKF-se”**

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

“Cactus” SH.A.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Bashkim Fehmiu Arbëria 3 BC2/11 V1- L01-S

(Adresa)

Prishtinë .. 10000

(Vendi)(Kodi postar)

038 246 888

(Numri Telefonit)

038 246 888

(Numri i Faks-it)

Astrit Leti, Drejtor Ekzekutiv

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@cactus.com

(Adresa elektronike)

19 Nentor 2020

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Ardi Shita, avokat

(Emri i avokatit)

Shita & Associates LLC
Anton Cetta 5a, Prishtinë, Kosovë

(Adresa e plotë)

044779949

038404505

(Numri i Telefonit) (Numri i faks-it)

ashita@shita.biz

(Adresa elektronike)

19.11.2020

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe



3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Dosja e Tenderit e përgatitur më 08.09.2020

Data e dorëzimit të tenderit: 02.10.2020

Data e shpalljes së fituesit : 30.10.2020

Data e kerkese tone per qasje ne dokumentet e kompanis fituese : 30.10.2020

Data e takimit te takimit per qasje ne dokumente: 02/11/2020

Data e Dorezimit te Kerkeses per Rishqyrtim: 03/11/2020

Vendimi I AK pas kerkeses per rishqyrtim: 11.11.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☒

Jo

☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 i LPP-se

Neni 56 i LPP-se

Neni 59 i LPP-se

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 41 i Rregulave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Me datë 30.10.2020, , Cactus SH.A. ka pranuar Njoftimin nga Autoriteti Kontraktues, në bazë të të cilit në procedurën e prokurimit si më lartë, si operator ekonomik i cili është eliminuar për shkak të pretendimit të mospërmbylljes së kërkesave dhe se fitues i këtij aktiviteti të prokurimit është shpallur OE Interlab SHPK

Brenda afatit ligjor të përcaktuar në Nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik (të plotësuar dhe ndryshuar, mëtutje "LPP"), OE "Cactus" SH.A. ka parashtruar Autoritetit Kontraktues, Kërkesën për Rishqyrtim për shkak të **shkeljes thelbësore të dispozitave të LPP-së dhe kriterëve teknike dhe profesionale të përcaktuara në Dosje të Tenderit, gjatë vlerësimit të tenderti ofertës së dorëzuar.**

Prove: Kërkesa për Rishqyrtim e OE Cactus SH.A

Me datë 11.11.2020, OE Cactus SHA ka pranuar vendimin e AK në lidhje me kërkesën për rishqyrtim, përmes të cilit AK e ka cilësuar Kërkesën/Ankesën si të pa bazuar dhe ka qendruar mbrapa vendimit të tyre që tenderi jone është i papërgjegjshëm dhe se fituesi i shpallur do të vazhdojë me procedurat e më tutjeshme.

Prove: Vendimi i AK-së i datës 11.11.2020

Andaj brenda afatit të paraparë ligjorë parashtrojmë këtë ankesë me argumentet si më poshtë:

1. Autoriteti Kontraktues n'a ka shpallur si OE jo të përgjegjshëm me arsyetimin që nuk i kemi paraqitur se paku 2 (dy) Kontrata se bashku me referenca për punët e ngjashme të përfunduara me heret.

Ashtu sic e kemi potencuar edhe në këkresën për rishqyrtim, pretendimi dhe arsyeja e AK-së është e paqendrueshme pasi që ne i kemi ofruar listen me 8 kontrata për punët e ngjashme dhe gjithashtu i kemi ofruar edhe referencat për këto punë të kryera, andaj AK ose nuk i ka shqyrtuar mirë dokumentet tona të dorezuara ose qëllimisht i ka anashkaluar referencat tona të paraqitura duke na shpallur të papërgjegjshëm.

Për më tepër, nëse konstatimi ynë që dokumentet e dorezuara bashkë me dosjen e tenderit nuk janë shqyrtuar nga AK është i gabueshëm – atëherë lind pyetja pse AK nuk e sqaron pse dhe cila nga këto dokumente nuk i përmbushë kriteret e parapara / kërkuara.

1.Mirembajtja, Servisim, Kalibrim dhe Updates Databaze per pajisjet te kontrollit te dokumenteve VSC Dhjetor 2016

2.Mirembajtja, servisimi dhe kalibrimi i Pasisjeve VSC - QC1

***3. Furnizim me paisje Servere per SPAR,09/18/DSH/HW
Implementation of Microsoft Dynamics NAV for SPAR Kosova,
KFSH-VENT- 01-2018 Furnizimi me paisje te teknologjise se
Informacionit dhe te Sigurise per SPAR Kosova J.S.C.,***

4. Service and maintenance of VSC_QC1 Equipment

5. Service and maintenance of VSC8000- 6000HS-6000 Equipment

6. Service and maintenance of VSC8000 Equipment

7. Supply and maintenance of MVC3000 Equipment

8. Service and maintenance of VSC8000 Equipment

2. Edhe sikur ne mos ti kishim plotësuar kriteret e paraqitura gjë e cila nuk qëndron, duhet ta theksojmë që OE fitues është shpallur fitues edhe pse nuk i ka plotësuar pikërisht kriteret e kërkuara, përkatësisht OE ka ofruar pajisje me performanca tjera nga ato që janë kërkuar në Dosjen e Tenderit. Kështu që, në këtë rast AK do të duhej që këtë tender t'a shpallë fitues kompanine tone apo te rishpallë si pasoje e asaj që asnjë ofertues nuk ka qenë i përgjegjshëm (gjithmonë nëse vlerësimi i AK-së ndaj dosjes tonë do të ishte is saktë - mirëqenë).

OE fitues nuk ka qenë i përgjegjshëm pasi që nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe këtë e kemi vërejtuar pas kërkesës sonë zyrtare për qasje në dokumentacion.

Per ta bere me te qartë këtë ceshtje ne e kemi përgatitur një tabelë në Excel ku e kemi bërë krahasimin me specifikacionet teknike për pajisjet të cilat ne i kemi ofruar dhe specifikacionet teknike te pajisjeve të ofruara nga OE Fitues.

Kriteret teknike jo te plotesuara nga OE i shpallur fitues nga AK:

- Regula supply their own database, not a Keesing database. Keesing is obviously somewhat more significant.
- The Regula device uses LED's throughout, i.e. they do not have a high power VIS-IR spot lamp as does the VSC8000/HS. They do not therefore have excitation filters.
- 3-D imaging. It is not clear whether Regula have 3-D imaging. They use an external device part it is not integrated.
- Regula unit supplied with built in PC, and graphics. We supply a high end external PC.
- No Band pass filter .

3 X OPTICAL ZOOM VIDEO MICROSCOPE & 5MPIXEL CAMERA

(VSC/PVM) Premium portable 3x optical zoom c-mount video microscope with integrated dimmable white LED lighting (runs off 4 AA batteries) - robust metal construction - adjustable focus throughout the zoom range - clear base allows easy positioning on documents and use of external oblique lighting (eg under VSC Workstation)

- supplied with 5Mpixel USB 3.0 CMOS colour digital camera and stand-alone software (not integrated with VSC software) plus 2 metre USB3.0 lead (compatible with USB2.0) - optional 2x magnifier - field of view 5.8-1.9mm, corresponding to a magnification of 82x-249x on a 32" 4k monitor (normal display mode) - field of view 2.9-0.95mm with optional 2x magnifier, corresponding to a magnification of 163x-498x

Operatori ekonomik nuk ka ofruar :

Garancion prej

1 vjet

Servisim dhe mirembajtje te pasijes per

1 vjet pas instalimit

Trainim per stafin e Agjencionit te Forenzikes per perdorim te paisjeve

Qertifikim te stafit profesional per mirembajtje te paisjeve

Gjithashtu për ta bërë sa më të kuptueshme këtë ceshtje ne do ta bashkangjesim me këtë Ankesë krahasimin e kriterëve teknike të kërkuara dhe atyre të ofruara nga OE Fitues.

Prove: Krahasimi i specifikacioneve të pajisjeve të kërkuara nga AK dhe specifikacioneve të pajisjeve të ofruara nga OE

Kështu AK ka bërë shkelje ligjore duke na eliminuar neve dhe duke favozuar një Operator tjetër Ekonomik i cili nuk i ka plotësuar as kushtet e kërkuara, pra vlerësimi është bërë duke na diskriminuar neve dhe favorizuar një OE ekonomik i cili nuk i ka plotësuar kriteret teknike të kërkuara.

Duhet të theksohet që AK në piken 4 të vendimit të datës 11.11.2020 thotë që operatori ekonomik fitues i ka ofruar pajisjet me kriteret e kërkuara mirepo në shqyrtim të dokumentacionit të dosjes së operatorit fitues ne e kemi gjetur të kundërtën në disa pika kyçe të asaj që thotë AK.

3. Autoriteti Kontraktues në pikën e 5 të vendimit të saj të datës 11.11.2020, thotë që ne nuk jemi palë me interes në këtë aktivitet të prokurimit duke aluduar në atë që jemi shpallur të papërgjegjshëm. Andaj ne dëshirojmë që ta theksojmë këtë duke ia rikujtuar AK që ne jemi palë me interes pasi që bazuar në të gjeturat në dosjen e OE fitues mendojmë që OE fitues është dashtë të shpallet i papërgjegjshëm ndërsa ne fitues ose në rast se edhe ne do të ishim të papërgjegjshëm, atëhere ky aktivitet i prokurimit do duhet të anulohet dhe të rishpallet.

Po e theksojmë këtë çështje pasi që AK, pa u shterrur të gjitha rrugët ligjore në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, aludon që ne nuk jemi palë me interes duke na bërë të besojmë që ka pas diskriminim gjatë vlerësimit dhe qëllimisht ne jemi cilësuar të papërgjegjshëm, e që nëse ishin analizuar mirë dokumentat do të duhej të ndodhte e kundërta, ku OE fitues do duhej të shpallet i papërgjegjshëm për mos plotësim të kritereve teknike të pajisjeve.

Si rezultat, kërkojmë nga OSHP që të aprovojë këtë kërkesë si të bazuar.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

- Fitimi i humbur si rezultat i humbjes së padrejtë të tenderit;
- Shpenzimet e përgatitjes së dosjes së tenderit;
- Shpenzimet e përfaqësimit në procedurë;
- Dëmi i shkaktuar nga humbja e padrejtë e tenderit rezulton edhe me dëm në humbje të referencës për kryerje të furnizimit.